



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 08.08.2023
Ref. KM-298/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) neni 15, Shtojca 11 të Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), dhe Nenin 20 (paragrafët 1, 4 dhe 5) të Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 44, datë 22.12.2008) si dhe në bazë të rekomandimit të Komisionit për vlerësim dhe autorizim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, me Ref.04-382/23, të datës 31.07.2023, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

VENDIM

Për futjen në regjistër dhe lejimin e autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve për përdorim

1. Lejohet importimi, vendosja në treg dhe përdorimi i autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve – **Valis F** i prodhuesit “**Belchim Crop Protection NV/SA**”, **Belgjikë** nga përfaqësuesi i saj “**Agronomi Group** ” SH.P.K, **Suharekë**.

2. **LLOJI I PRODUKTIT:** Fungicid

3. **PËRMBAJTJA E SUBSTANCËS AKTIVE:** Valifenalate.....60+- 6g/kg
Folpet.....480+-24g/kg

4. PËRDORIMI:

Valis F është fungicid kontak-sistemik i aplikuar në hardhitë e rrushit (varietetet e verës dhe tryezës) për kontrollin e vrugut (Plasmopara viticola) në sasi prej 2 kg/ha, sasia e ujit 100-1000 L/ha. Apilkohet në varietetet e verës nga faza e 5 gjetheve te zhvillimit deri në fazën e formimit të kokrrës (BBCH 15-83), dhe në varietete e tryezës nga faza e 5 gjetheve të zhvillimit deri në fund të lulëzimit (BBCH 15-69).Një maksimumi prej 2 aplikimesh gjatë një sezoni rritjeje janë të lejuara, me një distancë midis aplikimeve prej të paktën 10 ditësh.

5. SASIA E AMBALAZHIMIT PËR IMPORTIM:

1kg, 5kg, 10kg.

6. VËREJTJE:

Trajtimi nuk duhet të kryhet në mot me erë. Kur përdoret në varitetet e rrushit të tryezës, aplikimi i fundit duhet bërë jo më vonë se fundi i lulëzimit (BBCH 69). Aplikimi ajror nuk lejohet. Kur përdoret Valis F, rregullat e ujit duhet të respektohen në mënyrë që të mbrohet uji. Valis F nuk duhet të përdoret në zonat karstike dhe rërë të lehtë, skeletore dhe të gjitha tokat e tjera ku rritet rreziku i kalimit në ujërat nëntokësor. Nëse rregullohet e tjera nuk parashikojnë një distancë më të madhe sigurie, duhet të vërehet distanca e sigurisë nga uji sipërfaqësor në mënyrë që të mbrohen organizmat e dobishëm dhe jo të synuar- të matur nga skaji i bregdetit, i cili për aplikimet e miratuara është të paktën 20m me një rrip mbrojtës vegetativ shtresë prej 20m. Mbetjet e agjentit dhe spërkatësve nuk duhet të hyjnë në ujërat sipërfaqësor, ujërat e zeza, oborret dhe kanalet kulluese të qëndrueshme. Makinaria për aplikimin e pesticideve dhe sprucatorët duhet të lahen në fushë, në vendet ku agjenti nuk mund të arrijë ujërat sipërfaqësore dhe ku nuk ka rrezik për njerëzit dhe kafshët.

7. KARENCA:

28 ditë

8. PROPOZIMI I KLASIFIKIMIT:



GHS07- ngacmues, irritues (cat 2 ose 3)



GHS05-Paralajmërim për rrezikun-korroziv



GHS08-i dëmshëm për shëndetin



GHS09-paralajmërim i rrezikshëm për ambient.

9. VENDI I SHITJËS: Në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

10. Produkti për mbrojtjen e bimëve i autorizuar nga pika 1 e këtij vendimi lejohet të importohet në Republikën e Kosovës, deri në afatin siç është përcaktuar në certifikatën e regjistrimit, duke u bazuar në Databazën e Pesticideve të BE-se/Substancave aktive, ndërsa qarkullimi dhe përdorimi i tij lejohet sipas nenit 26 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

11. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Vendimi i dërgohet:

- *Komisioni për vlerësimin dhe autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve;*
- *Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve;*
- *Shërbimi kufitar fitosanitar;*
- *Inspektorët fitosanitar AUV;*
- *Importuesit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;*
- *Arkivit.*